



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:187400

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874483

KPPP.nr.1370/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Mjeshtri L.L.C., me NUI: 810821290, me seli në Prishtinë, rruga “Ahmet Krasniqi”, Tregtia C2, H8, 7A, kundër debitorit “Viva Fresh” SH.P.K., me NUI: 810670390, me seli në Graçanicë, Fshati Suhadoll, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.204/2023 të datës 04.08.2023 të Përmbartuesit Privat Kushtrim Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Viva Fresh” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.204/2023 të datës 04.08.2023 të Përmbartuesit Privat Kushtrim Metaj.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.204/2023 të datës 04.08.2023 të Përmbartuesit Privat Kushtrim Metaj.
- III. URDHËROHET debitori “Viva Fresh” SH.P.K., që në rast të parashtrimit ankesës, të deponoj në llogari të veçantë të “Këshillit Gjyqësor të Kosovës” nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 34,772.45 € (tridhjetë e katërmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy euro e dyzet e pesë cent), në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij aktvendimi.
- IV. Nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat Kushtrim Metaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Mjeshtri L.L.C., ka caktuar urdhrin P.nr.204/2023 të datës 04.08.2023, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturën Nr. PSI-21-000139 të datës 27.02.2021; Faturën Nr. PSI-21-000152 të datës 01.03.2021; Faturën Nr. PSI-21-000151 të datës 01.03.2021; Faturën Nr. PSI-21-000220 të datës 29.03.2021; Faturën Nr. PSI-21-00028 të datës 05.04.2021; Faturën Nr. PSI-21-000277 të datës 28.04.2021; Faturën Nr. PSI-21-000295 të datës 05.05.2021; Faturën Nr. PSI-21-000513 të datës 27.05.2021; Faturën Nr. PSI-21-000938 të datës 05.07.2021; Faturën Nr. PSI-21-000259 të datës 27.07.2021; Faturën Nr. PSI-21-001791 të datës 10.09.2021; Faturën Nr. PSI-22-000105 të datës 28.01.2022; Faturën Nr. PSI-22-000246 të datës 08.02.2022; Faturën Nr. PSI-22-000500 të datës 28.02.2022; Faturën Nr. PSI-22-001056 të datës 31.03.2022; Faturën Nr. PSI-22-001370 të datës 29.04.2022; Faturën Nr. PSI-22-001394 të datës 06.05.2022; Faturën Nr. PSI-22-001651 të datës 31.05.2022; Faturën Nr. PSI-22-001890 të datës 30.06.2022; Faturën Nr. PSI-22-002343 të datës 28.07.2022; Faturën Nr. PSI-22-002774 të datës 30.08.2022 dhe Faturën Nr. PSI-22-003251 të datës 30.09.2022, me të cilin e ka detyruar debitorin që t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 34,772.45 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e kalimit të afatit prej 7 ditësh të pagesës së faturave e deri në pagesën definitive të borxhit kryesor, kamatës, si dhe shpenzimeve të procedurës përmbarimore, duke u ekzekutuar me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës në llogarinë e veçantë të përmbaruesit privat, si dhe me regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, ashtu që nga shitja e realizuar të përmbushet borxhi në tërësi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se në bazë të marrëveshjes së lidhur mes kreditorit dhe debitorit, të dy palët kanë pasur bashkëpunim të mirë për një kohë të gjatë duke përmbushur në tërësi detyrimet dhe përgjegjësitë që kanë pasur ndaj njëri tjetrit, mirëpo për shkak të paqartësive dhe parregullsive të evidentuara për përcaktimin e gjendjes së obligimeve të mbetura, janë detyruar të ndërpresin bashkëpunimin dhe për këtë arsye ka ardhur deri tek mosmarrëveshja. Në lidhje me urdhrin përmbarimor ka deklaruar se palët kanë lidhur një marrëveshje jashtëgjyqësore, me anë të së cilës ishin dakorduar që në rast të çfarëdo kontesti që palët ndërgjyqëse mund të kenë në të ardhmen nuk do të marrin asnjë veprim apo procedurë ligjore lidhur me rastin. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të anulohet në tërësi si i pabazuar urdhri për përmbarim.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, ku ndër të tjerash ka deklaruar se propozimi për përmbarim është krijuar në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturave të cilat i kanë të gjitha elementet e nevojshme të parapara ligjore dhe si të tilla i kanë të gjitha tiparet e dokumentit të përmbarueshëm. Më tutje ka theksuar se edhe vetë debitori në prapësimin e tij ka pohuar borxhin sipas faturave të cekura si në propozim, ku palët ndërgjyqëse përmes nënshkrimit të “Marrëveshjes jashtëgjyqësore” kanë marrë detyrimin që borxhin në shumën prej 34,772.45 €, debitori t’ia paguaj kreditorit me kushtin që palët të mos e kontestojnë shumën e detyrimit sipas kësaj marrëveshje. Në fund ka deklaruar se koha e arritshmërisë së çdo fature ka qenë shtatë ditë nga data e lëshimit të tyre, andaj është absurde që debitori të pretendoj se nuk është i detyruar të përgjigjet sipas afateve të caktuara në faturë. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit, të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor dhe të detyrohet debitori që të paguaj garancionin në rast të ushtrimit të ankesës.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar* “. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturës Nr. PSI-21-000139 të datës 27.02.2021; Faturës Nr. PSI-21-000152 të datës 01.03.2021; Faturës Nr. PSI-21-000151 të datës 01.03.2021; Faturës Nr. PSI-21-000220 të datës 29.03.2021; Faturës Nr. PSI-21-00028 të datës 05.04.2021; Faturës Nr. PSI-21-000277 të datës 28.04.2021; Faturës Nr. PSI-21-000295 të datës 05.05.2021; Faturës Nr. PSI-21-000513 të datës 27.05.2021; Faturës Nr. PSI-21-000938 të datës 05.07.2021; Faturës Nr. PSI-21-000259 të datës 27.07.2021; Faturës Nr. PSI-21-001791 të datës 10.09.2021; Faturës Nr. PSI-22-000105 të datës 28.01.2022; Faturës Nr. PSI-22-000246 të datës 08.02.2022; Faturës Nr. PSI-22-000500 të datës 28.02.2022; Faturës Nr. PSI-22-001056 të datës 31.03.2022; Faturës Nr. PSI-22-001370 të datës 29.04.2022; Faturës Nr. PSI-22-001394 të datës 06.05.2022; Faturës Nr. PSI-22-001651 të datës 31.05.2022; Faturës Nr. PSI-22-001890 të datës 30.06.2022; Faturës Nr. PSI-22-002343 të datës 28.07.2022; Faturës Nr. PSI-22-002774 të datës 30.08.2022 dhe Faturës Nr. PSI-22-003251 të datës 30.09.2022, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura, i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe për të cilat ka qenë i njoftuar debitori, gjë e cila vërtetohet nga Marrëveshja jashtëgjyqësore Nr.16-6/23 e datës 16.06.2023 e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse, si dhe nga deklarimi nga ana e debitorit të paraqitur në prapësim se do të përmbushë në tërësi obligimin që ka ndaj kreditorit përmes realizimit të pagesave të pjeshme.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin që në rast të parashtrimt të ankesë kundër këtij aktvendimi, të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e

përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1370/23, datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.